



DITARI JAVOR

1 - 7 Prill

TASK FORCA ANTIKORRUPSION

Task Forca Antikorrupsion rekomandoi 9 masa disiplinore në Agjencinë Rajonale të Mjedisit Durrës, lidhur me respektimin e kërkesave ligjore në ushtrimin e funksioneve rregullatore për lejet e Mjedisit.

AKTIVITETI PËR “PAKTIN ME UNIVERSITETIN”

Takim konsultativ me studentë dhe pedagogë të Fakultetit të Drejtësisë, për ti dhënë më shumë mundësi studentëve për programe intership, fellowship, bashkëpunim për kërkime shkencore dhe iniciativa legjislative.

44 studentë të ekselencës kanë filluar punë pranë Ministrisë së Drejtësisë.

TAKIM ME STUDENTËT E EKSELENCËS NË APARATIN E MD

Takim me studentët e ekselencës të cilët janë punësuar në apartatin e Ministrisë së Drejtësisë. Fushat që mbulojnë janë Kodifikimi, Rregullimi i Profesioneve të Lira dhe Politikat Antikorrupsion. U diskutua për Paktin me Universitetin, duke theksuar angazhimin e Ministrisë së Drejtësisë për bashkëpunimin me Fakultetin e Drejtësisë.

CEREMONIA E DHURIMIT TË 2 AUTOBURGJE NGA SISTEMI PENITENCIAR HOLANDEZ

Reformat në sistemin penitenciar mbështeten nga partnerët tanë holandez.

Dy autoburgje u dhuruan nga Shërbimi Penitenciar holandez. Pas mbështetjes që qeveria holandeze ka dhënë për të miturit në sistemin penitenciar, donacioni i dy autoburgjeve do të rrisë sigurinë në transportimin e personave të dënuar nga një institucion në tjetrin apo nga institucioni në gjykata.